



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1

Nëse nuk të përgjigjem për 10 minuta, thirr policinë: Si u zbuluan dhoma e torturave në vilën luksoze në Spanjë, 7 anëtarë të një grupi kriminal serb arrestohen për rrëmbim dhe dhunim
- 2

Nëna i nxorri 3 fëmijët për një shetjetje dhe më pas i goditi me thikë në makinë, humb jetën 5-vjeçari në Australi, 2 të tjerët në gjendje kritike!
- 3

Manja 'kalon' nga opozita, debat me Berishën: Emri i Shkëlzenit del në dosjet e SPAK! Kreu i PD: Publikojë (VIDEO)
- 4

Ndihmonte Agasin, GJKKO lë në arrest shtepiak ish-kreun e SHISH, Viona Hysenit! Shkencore i çoi Agasit ekspertizën e makinës
- 5

Atentati në Durrës, autorin e 'nxjerr zbuluar' i atit! Goreja me dy fëmijë në makinë kur u qëllua, i dhunoi babanë atentatorit

Kronikë

Me armë zjarri në shtëpi, 2 të arrestuar në Tiranë e Krujë! Sekuestrohen pistoletë, kallashnikov e shënjestër optike (EMRAT)

36-vjeçarit [Adi Zavalani](#) në Tiranë i janë gjetur në shtëpi 1 pistoletë dhe 1 kallashnikov, fishekë, një shënjestër optike, 2 mjete prerëse dhe një peshore elektronike. Të arrestuarit tjetër, [Fatos Lika](#), 28 vjeç, i janë gjetur një armë gjahu, 84 fishekë dhe 17 kapsolla elektrike.

Me armë zjarri në shtëpi, 2 të arrestuar në Tiranë e Krujë! Sekuestrohen

Report TV



Watch on

[Sh] Redaksia
24 Shtator, 08:52 | Përditësimi: 24 Shtator, 09:14

Share Post WhatsApp



Dy persona, një në [Tiranë](#) dhe një në Brret të Krujës, janë vënë në pranga nga policia për [armëmbajtje pa leje](#).

36-vjeçarit [Adi Zavalani](#) në Tiranë i janë gjetur në shtëpi 1 pistoletë dhe 1 kallashnikov, fishekë, një shënjestër optike, 2 mjete prerëse dhe një peshore elektronike.

Të arrestuarit tjetër, [Fatos Lika](#), 28 vjeç, i janë gjetur një armë gjahu, 84 fishekë dhe 17 kapsolla elektrike.



LEXO EDHE:
Krujë/ Makina përfundon e kthyer përmbys në kanal, plagosen rëndë dy të rinj, dërgohen te Trauma

Të gjitha objektet e gjetura janë sekuestruar.

Njoftimi i policisë:

DVP Tiranë/Finalizohen në 24 orë, si rezultat i punës operative, 2 operacione për ndalimin e shtetasve që mbajnë armë, pa leje.

Sekuestrohen 3 armë, 17 kapsolla elektrike, municion luftarak, një shënjestër optike, 2 mjete prerëse dhe 1 peshore elektronike.

Arrestohen 2 poseduesit e sendeve të kundërligjshme.

Si rezultat i shtimit të vigjilencës operacionale në të gjithë territorin e qarkut dhe intensifikimit të punës operative, me qëllim parandalimin e ngjarjeve kriminale që mund të kryhen nga shtetas që posedojnë ilegalisht, armë, u finalizuan në 24 orë, 2 operacione. Konkretisht:

-Forca e Posaçme “Shqiponja”, në bashkëpunim me shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 4, në kuadër të operacionit të koduar “Qëllimi”, arrestuan shtetasin A. Z., 36 vjeç (me precedent penal), pasi iu gjetën në banesë, 2 armë zjarri (pistoletë dhe automatike), municion luftarak, një shënjestër optike, 2 mjete prerëse dhe 1 peshore elektronike;

-shërbimet e Komisarariatit të Policisë [Krujë](#), në kuadër të operacionit të koduar “Kontrolli”, arrestuan shtetasin F. L., 28 vjeç, në banesën e të cilit, në fshatin Brret, u gjetën 1 armë gjahu, 84 fishekë dhe 17 kapsolla elektrike, që posedoheshin pa leje.

Vijojnë hetimet për të zbardhur dhe dokumentuar përfshirjen e 2 shtetasve të arrestuar, në veprimtari kriminale.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë

P.J/Shqiptarja.com

TAG: [adi zavalani](#) [Tirane](#) [krujë](#) [fatos lika](#) [armëmbajtje pa leje](#)

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★★★★★

★ LAJMET MË TË VLERËSUARA >

Komente

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës:
Arrestimet e fundit nga SPAK, a janë provë e pavarësisë nga politika?

22 Shtator, 16:08

Po Jo Disi

Lajme të tjera



Tre vatra zjarri në Krujë, digjen pyje me pisha, paraqitet edhe rrezik për banesat! Flakë në autostradën Lezhë-Shkodër, tymi i dendur mbulon zonën (VIDEO)

24 Shtator, 14:07



Mbante armë automatike dhe fishekë në banesë, arrestohet 64-vjeçari në Patos (VIDEO)

24 Shtator, 11:20



Protestuesit përplasen me policinë, 17 të shoqëruar! Një qytetar ndihet keq mes turmës, merret nga ambulanca (PAMJET ME DRON)

24 Shtator, 09:59



Vrasja e 49-vjeçarit në Tiranë, autori: Debatuam në lokal, shkova në shtëpi dhe mora thikën! Burime: Njihet si përdorues droge

24 Shtator, 08:59



Sherr me thika në një lokal në Tiranë, plagoset 49-vjeçari, ndërron jetë në spital! Arrestohet autori (EMRAT)

23 Shtator, 21:58



Gara Tiranathlon mbahet të dielën në kryeqytet, Bashkia: Ja rrugët ku do të kufizohet qarkullimi i automjeteve në kryeqytet

23 Shtator, 19:28



Arabia Saudite kremton Ditën Kombëtare, ambasadori Al-Madi: Mundësi të reja bashkëpunimi me Shqipërinë nga ekonomia te kultura

23 Shtator, 19:06



Kërcënoi me thikë 50 vjeçaren gjermane te Liqeni Artificial dhe i grabiti çantën, arrestohet 41-vjeçari në Tiranë (VIDEO)

23 Shtator, 14:20



Koha për të mbrojtur titullin botëror, Jurgjen Uldedaj ndeshje historike në Tiranë më 23 tetor

23 Shtator, 11:03



Me dy nivele për makinat e autobusët dhe hapësira të gjelbëruara, si do të duket parkimi i ri nëntokësor te Liqeni i Tiranës (VIDEO+FOTO)

23 Shtator, 10:50



Tiranë/ 36-vjeçari i dha fund jetës, arrestohet babai i ish-bashkëjetueses! Kishin debatuar 2 ditë para ngjarjes, dyshohet se i bënte presion

Sokol Dema

23 Shtator, 10:00



Aksident me vdekje në Tiranë/ Një automjet përplaslet me një motor, humb jetën 64-vjeçari

22 Shtator, 16:31



“Shame and money”/ Filmi i Visar Morinës, premierë në Tiranë

24 Shtator, 15:07

[nga Blerina Goce](#)





×

[Sh]

.com

Lajmi i fundit

“Shame and money”/ Filmi i Visar Morinës, premierë në Tiranë

24 Shtator, 15:07nga Blerina Goce

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

